



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT

OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Data/Date/Datum:	08.05.2023
Për/To/ Za:	Doruntina Hasani – Drejtoreshë e DAP
Cc:	Kryetarin e Komunës z. Alban Hyseni
Përmes/ Through/ Preko	
Nga/From/Od:	Ardian Foniqi – Zyrtar juridik
Lënda/ Subject/Tema:	Raport i konsultimeve publike me qytetarë të Grupit Punues për Hartimin e Planit të Integritetit Komunal për Periudhën 2023 - 2027

Raporti për Hartimin e Planit të Integritetit Komunal për Periudhën 2023 – 2027, konsultimeve publike me qytetarë.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale për Konsultime Publike në Komuna, neni 5, pika 5 e këtij udhëzimi, po ju paraqes raportin e konsultimeve publike me qytetarë të Grupit Punues për Hartimin e Planit të Integritetit Komunal për Periudhën 2023 – 2027, i cili është mbajtur në Sallën e Kuvendit të Komunës, më 05.05.2023 me fillim nga ora 10:00.

Në këtë dëgjim publik me qytetarë kanë marrë pjesë të anëtarët e grupit punues të planit të Integritetit komunal 2023/27, Drejtoresha e DAP, Doruntina Hasani e cila njërit ka qenë kryesuese e grupit punues dhe prezantuese e planit të Integritetit 2023/27, Drejtori i DUMM, z. Ali Arifi, dhe Drejtori i DGJKP, Bekim Salihu dhe mbi 22 qytetarë.

Doruntina Hasani - kryetare e grupit punës në emër të grupit të HPIK, pasi që i përshëndeti të pranishmit në dëgjim publik, para qytetarëve ka shpalosur Planin e Integritetit Komunal për Periudhën 2023 –

2027, ndër të tjera tha se ky plan i në komuna 2023/2027, ky plane është hartuar duke u bazuar në strategjinë kombëtare të Republikës së Kosovës, kundër korrupsionit dhe planit të veprimit kundër korrupsionit ky është një dokument shume i rëndësishëm bazuar edhe në te gjitha dokumentet e institucioneve të Kosovës, duke i përfshirë këtu edhe komunat e RKS-ës, që duhet ta keni këtë plan të integritetit.

Njëherit i njoftoj qytetarët për procesin dhe strukturën e Planit të Integritetit, po ashtu kanë qenë dy pyetje nga qytetarët Xhemal Veseli i cili parashtroj pyetje rrethe komisionit i cili do ta mbikëqyr planin e integritetit si dhe çështjen e informimit të shpenzimeve të parasë publike i cili komision do të jetë nga zyrtaret po a do të këtë edhe ndonjë anëtar nga shoqëria civile.

Drejtoresha e DAP- Doruntina Hasani, tha se kjo është njëra prej masave që konsiderohet dhe që është paraparë që të ndërmerret që të menaxhohet në formën me transparente buxheti komunal e të çështja e përbërjes së këtij komisioni kemi paraparë që pjesë e këtij grupi punues mos me qenë vetëm zyrtarët komunal të cilët që mund të jen të ndikuar nga politika prandaj edhe përbërja prej organizatave dhe anëtarëve të shoqërisë civile mediave dhe akterve tjerë do ta rriste transparencën.

Po ashtu Fatime Rrahmani pyeti për zbatimin e planit të integritetit dhe a keni bërë ndonjë hulumtim paraprak dhe a keni denjë mekanizëm për implementim të tashëm ku do të matet performanca e komunës siç e thatë edhe ju vet.

Drejtoresha e DAP- Doruntina Hasani ne përgjigje tha se në planin e integritetit paraprak mund t'na ndihmoj zyrtarja e personelit për shkak e jam e njoftuar se në kohën kur ka qenë aktiv plani i integritetit ka qenë periudha e pandemisë.

Ndërsa zyrtarja e lart e personelit Fatushe Haliti tha se ky plan që ka mbetur ne gjysmë është për shkak të pandemisë dhe nuk është zgjedhur koordinatori dhe grupi punës i planit të integritetit.

Në fund të takimit fjalën përmbyllës e mur nënkryetarja e komunës Leunora Morina – Bunjaku, pas përshëndetjes të të pranishmëve ku ndër të tjerat tha se të flasim për planin e integritetit duhet të gjithë të marrim përgjegjësi dhe ky plan synon të kontribuoj në ndërtimin e një administratë të moderuar dhe profesionale dhe të qëndrueshme me qëllim që të ngritjes se mirëqenies se qytetarëve përmes shërbimeve sa me cilësorë për qytetarët.

Ndërsa konsultimi publik me Grupin Punues për Hartimin e Planit të Integritetit Komunal për Periudhën 2023 – 2027, përfundoj në ora 11:30.